

**UDHËZIM I PËRBASHKËT**  
**Nr. 1310/2, datë 24.9.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE**  
**STATISTIKORE QË KRYEN INSTAT-i NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 36, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, si dhe të pikës 3, të vendimit nr. 393, datë 19.6.2019, “Për llojet e shërbimeve statistikore që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve kundrejt tarifave të paracaktuara”, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it,

**UDHËZOJNË:**

1. Shërbimet statistikore dhe tarifrat (pagesat) për këto shërbime, jepen në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
  2. Autoriteti përgjegjës për mbledhjen e tarifave, sipas niveleve të përcaktuara në aneksin 1, është Instituti i Statistikave.
  3. Pagesa e tarifës kryhet nga marrësi i shërbimit ose përfaqësuesi i tij në llogarinë bankare të INSTAT-it.
  4. Tarifrat e shërbimeve publikohen në faqen zyrtare të internetit të Institutit të Statistikave dhe bëhen të aksesueshme lehtësisht nga të interesuarit. Masa e tarifave të shërbimeve është variabël dhe përcaktohet rast pas rasti, sipas elementeve të kostos së vendosur për çdo shërbim në aneksin 1.
  5. Për një ose grup shërbimesh statistikore të caktuara, kërkuesi i shërbimit dhe INSTAT-i nënshkruajnë një kontratë paraprake shërbimi, objekti i të cilës kryhet kundrejt tarifave të këtij udhëzimi.
  6. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kontratën për kryerjen e shërbimit statistikor, INSTAT-i e kryen shërbimin për llogari të të interesuarit vetëm pas paraqitjes së kërkesës dhe mandatit të arkëtimit për shërbimin.
  7. Të ardhurat nga tarifrat e mbledhura derdhen 10 % në buxhetin e shtetit dhe 90% përdoren nga INSTAT-i, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 36, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”.
  8. Të ardhurat nga tarifrat e mbledhura shpërndahen brenda vitit të krijimit të tyre, sipas propozimit të bordit drejtues, mbështetur në pikën “dh”, të nenit 20, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”.
  9. Në rast se shërbimet kryhen në kuadër të marrëveshjeve me donatorët, shpërndarja e të ardhurave bëhet sipas përcaktimeve të marrëveshjes përkatëse. Në rastet kur shpërndarja e të ardhurave nuk është e përcaktuar në marrëveshjen me donatorët, atëherë zbatohen dispozitat e këtij udhëzimi.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCave DHE EKONOMISË  
**Anila Denaj**

ZËVENDËSKRYETAR I BORDIT DREJTUES TË INSTAT-it  
**Elsa Dhuli**

## Aneksi 1

### Tarifat për shërbimet statistikore

#### 1. Përpunim i të dhënave nga databazat e brendshme

##### a) Punë direkte, përfshirë:

- i. kalkulime;
- ii. tabelime;
- iii. prodhim grafikë;
- iv. *data entry*;
- v. etj.

Elementet e kostos:

- orë pune (mesatarja e pagës së specialistit/përgjegjësit/drejtorit të drejtorisë/DP).

##### b) Materiale direkte

Elementet e kostos:

- letër printim - 10 lek/fq.;
- CD - 50 lek/copë;
- *flash drive* - 1000 lek/copë;
- programe kompjuterike - 500 lek/orë.

##### c) Shpenzime të përgjithshme për produktin, 10% të vlerës së shërbimit:

Elementet e kostos:

- tonera;
- pajisje kompjuterike;
- kancelari;
- energji elektrike.

#### 2. Shërbime publikimi për të tretët

##### a) Punë direkte, përfshirë:

- i. dizejim;
- ii. tekste;
- iii. përkthime teknike;
- iv. prodhim grafikë;
- v. infografe.

Elementet e kostos:

- orë pune (mesatarja e pagës së specialistit/përgjegjësit/drejtorit të drejtorisë/DP).

##### b) Materiale direkte

Elementet e kostos:

- letër printim - 10 lekë/fq.;
- CD - 50 lek/copë;
- *flash drive* - 1000 lek/copë;
- shtypshkrime (në varësi të nr. të faqeve/llojit të letrës);
- programe kompjuterike - 500lek/orë.

##### c) Shpenzime të përgjithshme për produktin, 10% të vlerës së shërbimit:

Elementet e kostos:

- tonera;
- pajisje kompjuterike;
- kancelari;
- energji elektrike.

### 3. Shërbime vrojtimi/pjesë të tyre

#### a) Punë direkte, përfshirë:

- i. kampionim;
- ii. rekrutim dhe trajnim të punonjësve të terrenit;
- iii. mbledhje, hedhje dhe përpunim i të dhënave.

#### Elementët e kostos:

- orë pune (mesatarja e pagës së specialistit/përgjegjës/drejtorit të drejtorisë/DP);
- shpenzime të përgjithshme për produktin, 10% të vlerës së shërbimit.

Pagesa e stafit të rekrutuar me kohë të pjesshme për proceset e mbledhjes, hedhjes, përpunimit dhe kontrollit të të dhënave, si dhe materialet logjistike të nevojshme për kryerjen e vrojtimeve, përcaktohen rast pas rasti duke u bazuar në rastet e ngjashme.

Në rastin e shërbimeve që kryhen me kërkesën e donatorëve, vlera e shërbimeve kryhet në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar mes palëve.